VENDIM
Nr.1459, datë 5.11.2008

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a" të paragrafit të parë të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2008, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Programit "Mbështetje për minierat dhe ndërmarrjet publike", zëri "Shpenzime kapitale, të brendshme", t'i shtohet fondi 21 000 000 (njëzet e një milionë) lekë.

b) Programit "Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut dhe infrastrukturën e cilësisë", zëri "Shpenzime kapitale, të brendshme", t'i shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

c) Programit "Mbështetje për zhvillim ekonomik", zëri "Shpenzime kapitale, të brendshme", t'i pakësohet fondi 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë, si shumë e fondeve të përcaktuara në shkronjat "a" e "b" të pikës 1 të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha